

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

#### Specifikimi i Materialeve:

#### 1. Specifikimet Teknike të pajisjes së Ticket Dispenserit (pajisja e cila printon biletat e radhës, KIOSK) janë si më poshtë:

- Ekran TFT me prekje (touch screen)
- Ekran minimalisht 17"
- Në ekran duhet të shfaqen minimalisht 8 (tetë) shërbime
- RAM minimal 4 GB DDR3
- Madhësia e Hard Diskut "HDD Size": min 500 GB ose 128 SSD
- Portat e komunikimit :VGA ose DVI, HDMI, USB, RJ 45, HD Audio (Line-In, Line-out, Mic-in)
- Networking : LAN Ethernet 10/100, Wireless LAN 802.11 b/g/n
- "Power Supply" : 220V/50Hz
- Struktura: metalike e fabrikuar
- Mbrojtje kundër thyerjeve: e përfshirë
- Sistemi i shfrytëzimit: i hapur dhe licensuar
- Rezolucioni: min 203 dpi
- Paper out alarm në përfundim të letrës
- Ticket Dispenser duhet të ketë të inkuorporuar një printer thermal për printimin e biletave të radhës
- Shpejtësia e printimit duhet të jetë minimalisht 60 mm/sek
- Formatit i letrës : Thermal roll 60, 80, 82.5 mm
- Në biletën e printuar do të shfaqet: Numri i zgjedhur, shërbimi i zgjedhur, emri i institucionit, logo e institucionit, data, ora dhe numri i njerëzve të cilët janë duke pritur
- Numri i radhës duhet të risetohet në ditën pasardhëse.
- Sistemi duhet të suportoje një numër të palimituar rradhësh.
- Garancia e pajisjes: min 6 muaj

#### 2. Ekranet e Sporteve

- Sistemi duhet të ketë të integruar ekrane sportelesh të cilat duhet të jenë lehtësisht të dukshme në ambjentin e shërbimit
- Ekranin në çdo sportel duhet të jetë LED
- Ekranin LED do të shfaqë numrin e biletës

### 3. Ekranin LCD/LED për afishimet në lidhje me radhën

- Afishimet në lidhje me ecurinë e radhës do të shfaqen në ekranin LCD/LED.
- Ekranin duhet të jetë i madhësisë minimalisht 19”(inch)
- Në ekran duhet të shfaqet numri i sporteleve dhe numri i radhës që po shërbehet për të gjithë sportelet në dy rreshta dhe dy kolona
- Për çdo veprim të operatorit për thirrjen e biletës, ndryshimi do të pasqyrohet në ekran
- Garancia min 6 muaj

### 4. Sistemi i rradhës

- Sistemi i rradhës duhet të jetë një program i cili bazohet mbi një bazë të dhënash (e hapur ose e licensuar) dhe ruan çdo informacion që lidhet me rradhën apo njoftimet e ndryshme të institucionit
- Sistemi duhet të ketë ndërfaqe për platformën kiosk dhe të mundësojë printimin e biletës sipas shërbimit të kërkuar
- Sistemi duhet të ketë një ndërfaqe për platformën LCD/LED për shfaqjen e informacionit të rradhës
- Sistemi duhet të mbështesë punonjësit me përdorues të veçantë, në rastet e kërkimit të numrit të rradhës duhet të ruajë përdoruesin si dhe datën dhe orën e kërkimit të rradhës
- Sistemi të ketë një formë administrimi informacioni në lidhje me numrin e rradhëve aktive sipas ditëve si dhe raportim të aktivitetit ditor
- Në rast fikje të sistemit dhe rindezje të tij, ai duhet të ruajë të dhënat me të cilat po punonte në mënyrë që të mos shkaktohet konfuzion me rradhën e klientëve
- Sistemi duhet të jetë i monitorueshëm përmes një kompjuteri ose lidhjes remote
- Sistemi i tëri kontrollohet nga PC, me anë të cilit bëhet menaxhimi i sistemit
- Sistemi të punojë me kabuj rrjeti ose me wireless (pa kabuj)
- Sistemi të ofrojë mundësinë për shtimin e sporteleve dhe shërbimeve ku përfshihet shtim, heqje dhe modifikim
- Trajnimi i përdoruesve të sistemit dhe i stafit për administrimin e sistemit
- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit do të bëhet nga kompania fituese e cila duhet të ofrojë suport 1 vit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi me materiale biletarie do të bëhet me perputhje me njësinë matesë që kërkon natyra e secilit mall që do të dorëzohet.

